



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 161, datë 19.2.2020

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLAVE TË NEVOJSHME
PËR PARANDALIMIN DHE REDUKTIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT
NGA ASBESTI¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 23, të ligjit nr.27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është përcaktimi i rregullave dhe plotësimi i kuadrit nënligjor që lidhet me parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga asbesti, në interes të mbrojtjes së shëndetit të njeriut dhe të mjedisit.
2. Këto rregulla zbatohen në përputhje dhe pa cenuar legjislacionin specifik për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet që lidhen me asbestin në vendin e punës, legjislacionin që përcakton ndalimet mbi prodhimin, vendosjen në treg dhe përdorimin e fibrave të asbestit, të përzierjeve dhe produkteve që përmbajnë asbest dhe legjislacionin për menaxhimin e integruar të mbetjeve.
3. Për qëllime të këtij vendimi, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:
 - a) “**Asbest**”, silikatet me strukturë fibroze, si më poshtë vijon:
 - i. Krocidolite (asbesti blu), Nr.CAS: 12001-28-4;
 - ii. Aktinolite, Nr. CAS: 77536-67-5;

¹ Ky projektvendim transponon pjesërisht Direktivën e datës 19 mars 1987, nr.87/217/EEC, lidhur me parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti, e amenduar (version i konsoliduar i datës 04.07.2018) CELEX nr: EUR-Lex-1987L0217.

- iii. Antofilite, Nr.CAS: 77536-66-4;
 - iv. Krisotile (asbesti i bardhë), Nr.CAS: 12001-29-5; Nr.CAS: 132207-32-0;
 - v. Amosite (asbesti kaf), Nr.CAS: 12172-73-5;
 - vi. Tremolite, Nr.CAS: 77536-68-6;
- b) **“Trajtim i produkteve që përmbajnë asbest”**, aktivitete të ndryshme nga ato që përdorin asbest, por që janë përgjegjëse për shkarkimet e asbestit në mjedis nga produktet e trajtuara;
 - c) **“Pluhur asbesti”**, pluhuri që lëshohet nga asbesti, nga produktet që përmbajnë asbest ose mbetjet e asbestit.

II. RREGULLAT PËR PARANDALIMIN DHE REDUKTIMIN E NDOTJES SË MJEDISIT NGA TRAJTIMI I PRODUKTEVE QË PËRMBAJNË ASBEST

1. Ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me autoritetet shtetërore përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë, përgatisin udhëzimin teknik mbi rregullat për parandalimin dhe reduktimin e ndotjes nga trajtimi i produkteve që përmbajnë asbest lidhur me:
 - a) shkarkimet e asbestit në ajër;
 - b) shkarkimet e asbestit në ujë;
 - c) mbetjet e ngurta, që përmbajnë asbest.
2. Çdo person fizik ose juridik, që trajton produkte që përmbajnë asbest, duhet të marrë masat dhe të sigurojë se:
 - a) aktiviteti që ai kryen nuk shkakton ndotje të mjedisit nga fibrat ose pluhuri i asbestit;
 - b) ka marrë masat për të shmangur ndotjen nga produktet që përmbajnë asbest, mbetjet e tjera nga asbesti, fibrat ose pluhuri i asbestit;
 - c) punimet që ndërmerr, me qëllim prishjen, shëmbjen e ndërtesave, të strukturave dhe instalimeve që përmbajnë asbest, heqjen apo largimin prej tyre të asbestit ose të materialeve që përmbajnë asbest, duke përfshirë fibrat ose pluhurin e asbestit që lëshohet në ajër, nuk shkaktojnë ndotje të mjedisit nga asbesti dhe kryhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet që lidhen me asbestin në vendin e punës;
 - ç) përpara fillimit të punimeve, të parashikuara në shkronjën “c”, të hartojë planin e punës në përputhje me kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e punëmarrësve nga risqet që lidhen me asbestin në vendin e punës. Plani i punës përfshin të gjitha masat e nevojshme, parandaluese, që

ndërmerren për të reduktuar ndotjen e mjedisit nga fibrat ose pluhuri i asbestit.

3. Fibrat e asbestit, pluhuri i asbestit, produktet e ndotura me asbest, që gjenerohen nga aktivitetet ose punimet e përcaktuara në pikën 2, të këtij kreu, konsiderohen mbetje të rrezikshme, sipas vendimit nr.99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e katalogut shqiptar të mbetjeve”, të ndryshuar.
4. Trajtimi i mbetjeve të asbestit dhe paketimeve që përmbajnë pluhur asbesti ose fibra asbesti kryhet nga persona fizikë/juridikë të pajisur me leje mjedisi, në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, dhe licencën për veprimtaritë e tjera profesionale, lidhur me ndikimin në mjedis, me kodin III.2.B, të cilët duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar se:
 - a) menaxhimi i mbetjeve të asbestit bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
 - b) gjatë transportimit dhe depozitimit të mbetjeve të asbestit ndalohet çlirimi në ajër i fijeve ose pluhurit të asbestit si dhe derdhja e shkarkimeve të lëngëta, që mund të përmbajnë fibra asbesti;
 - c) mbetjet, që përmbajnë fibra ose pluhur asbesti, të cilat transportohen dhe asgjësohen në *landfill*, janë të trajtuara, të paketuara dhe të etiketuara me qëllim parandalimin e lëshimit dhe të përhapjes së fibrave ose pluhurit të asbestit në mjedis.
5. Për qëllime të këtij vendimi dhe në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e kimikateve, ministria përgjegjëse për mjedisin, ministritë e linjës, përgjegjëse për fushat që mbulojnë, dhe strukturat e tyre të varësisë bashkëpunojnë ndërmjet tyre, me qëllim parandalimin dhe reduktimin e ndotjes së mjedisit nga asbesti dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.

III. SANKSIONET

Mosrespektimi i parashikimeve të këtij vendimi kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë, sipas pikës 37, të nenit 40, të ligjit nr.27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, dhe të nenit 62, të ligjit nr.10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, të ndryshuar.

IV. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe

Mbrojtjes Sociale, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e
Infrastrukturës dhe Energjisë dhe institucionet në varësi të tyre për zbatimin e
këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi 2 (dy) vjet pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

MINISTRI I TURIZMIT
DHE MJEDISIT

BLENDI KLOSI

Në mungesë dhe me porosi,

ZËVENDËSMINISTRI

ORNELA ÇUÇI

NR.PROT. 967/1
DATE 20. 2. 2020

MINISTRISË SË TURIZMIT DHE MJEDISIT
MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES
SOCIALE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE
ENERGJISË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjëll AGAÇI



The image shows a handwritten signature in blue ink that reads "Engjëll Agaçi". The signature is written over a circular official stamp. The stamp contains the text "REPUBLIKA E SHQIPARISË" at the top, "KESHILLI I MINISTRAVE" at the bottom, and a central emblem of the Albanian coat of arms. The signature is written in a cursive style.